

THJESHT TË SIGURT NË SHKOLLË

graz.at/schulstrassen



TË DASHUR PRINDËR, MIRË SE VINI NË RRUGËN SHKOLLORE!

Rruga e re shkollore përshëndet qarkullimin origjinal të motorizuar me ecjen në këmbë, çiklizmin dhe vozitjen me skuter. Në këtë mënyrë, ne punojmë së bashku që fëmijët të jenë më të sigurt dhe për një cilësi më të mirë të ajrit përreth shkollave tona.

Çfarë do të thotë kjo konkretisht:

Rreth shkollave dhe vetëm në ditët e shkollës janë të vlefshme: Seksione të caktuara rrugore **mbyllen gjysmë ore para fillimit të shkollës** për makinat, në varësi të shkollës nga ora 7:15 deri në orën 7:45 ose nga ora 7:30 deri në orën 8:00. Periudha përkatëse kohore shpallet në tabelat shtesë në shenjat e qarkullimit rrugor.

Ndihmoni në reduktimin e qarkullimit të motorizuar nëpër shkolla dhe lëroni fëmijët tuaj të shkojnë në shkollë në mënyrë të pavarur dhe aktive. Fëmijët që duhet t'i sillni me makinë mund të zbresin në stacionet e qëndrimit të prindërve pranë shkollës.

Në ditët e shkollës vlen gjysmë ore para fillimit të mësimi:

- Ndalohet qarkullimi i automjeteve në rrugët e shkollave!
- Me përjashtim të: Transportit publik, transportit shkollor, automjeteve të urgjencës, transportit të ambulancës, shërbimit rrugor dhe grumbullimit të plehrave si dhe ardhja dhe largimi i banorëve - me shpejtësinë e këmbësorit.
- Lejohet çiklizmi.
- Shpejtësia e ecjes vlen edhe për çiklistët dhe drejtuesit e skuterëve.
- Ecja është e lejuar edhe në rrugë – ju lutemi kini kujdes.
- Krahas sinjalistikës së qarkullimit „Schulstraße“ (Rruga shkollore), pjesa rrugore në fjalë është e siguar edhe me pengesa fizike për qarkullim të paautorizuar të mjeteve motorike.



TË SIGURT NË TË ARDHMEN

graz.at/schulstrassen



GRAZ

LËVIZJA THJESHT BËN MIRË

- **Më mirë të jeni aktiv sesa pasiv:** Kur fëmijët shkojnë në shkollë dhe nuk shoqërohen me makinë, ata bëhen më të lëvizshëm dhe forcojnë ndjenjën e tyre të orientimit dhe koordinimit. Kjo u vjen atyre në ndihmë për të gjithë jetën.
- **Më mirë të kini kujdes:** Kush ecën disa qindra hapa në këmbë në mëngjes, arrin të përqendrohet dhe të marrë pjesë shumë më lehtë në mësim.
- **Të shëndetshëm dhe miqësor ndaj mjedisit:** Çdo hap në këmbë, çdo lëvizje me pedalet e biçikletës është një kontribut i vlefshëm për shëndetin dhe mbrojtjen e klimës dhe promovon krijimtarinë.

MË SHUMË SIGURI HAP PAS HAPI

Shkollat, mësuesit, shoqatat e prindërve, banorët, policia dhe qyteti i Gracit punojmë së bashku për t'u ofruar më shumë siguri fëmijëve tanë.



Të dashur prindër, bashkohuni me ne!

Ndaleni makinën tuaj dhe lejoni që fëmijët tuaj të shkojnë në këmbë në shkollë. Me ndihmën tuaj ne do t'i bëjmë rrugët e shkollave një vend të sigurt për të gjithë fëmijët.

Shkollat e Gracit falënderojnë përzemërsisht!

Për më shumë informacion për risinë në rrugën shkollore:
graz.at/schulstrassen